

Thirrje për aplikim - vijimi i një semestri (baçelor) në Linnaeus University, Suedi

Të nderuar studentë!

Në kuadër të projektit nga *programi Erasmus+ Higher Education Student and Staff Mobility 2023-2026* në mes të Universitetit të Prishtinës dhe Universitetit Linnaeus në Vaexjo (Suedi), FIEK ka mundësi të mbështes studentët e drejtimit Inxhinieri Kompjuterike dhe Softuerike të mbarojnë **një semestër të studimeve baçelor në Universitetin Linnaeus, Suedi**.

I ftojme studentet e vitit të tretë - drejtimi **Inxhinieri Kompjuterike dhe Softuerike** të aplikojnë në këtë thirrje.

Do të përzgjedhen 3 studentë. Përzgjedhja do të bëhet bazuar në suksesin e deritanishëm në studime. Studentët e përzgjedhur do të fillojnë mësimin në semestrin **pranveror 2026**.

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Certifikata e notave/transkripta (në gjuhën angleze);
- CV (në gjuhën angleze);
- Kopje e pasaportës (faqja që përmban emrin tuaj, foton dhe të dhënat personale);
- Një letër motivimi (në gjuhën angleze);
- Vërtetim që jeni student (i lëshuar nga fakulteti juaj, që konfirmon nivelin tuaj të studimeve dhe vitin akademik);
- Certifikata e njohjes së gjuhës angleze (minimumi niveli B2).
- Nota mesatare duhet të jetë jo më pak se 8.00.

Aplikimin se bashku me dokumentet e kërkuara i dërgoni në e-mailin: artan.mazrekaj@uni-pr.edu

Afati i aplikimit është deri me **24 shtator 2025 në ora 16:00**.

Aplikimi pas këtij afati nuk merret parasysh!

Për më shumë informacione rreth universitetit mund ta vizitoni ueb faqen:

[A modern university in Småland in southern Sweden | Inu.se](#) , [List of courses open for exchange students](#)